

ERION KRISTO

Titulli: Doktor i Shkencave

Fusha e ekspertizës kërkimore: Filozofi; Antropologji; Sociologji

Dr. Erion Kristo, është diplomuar në Universitetin “San Tommaso”, Fakulteti i Filozofisë, për Filozofi në vitin 1994. Në vitin 1996 ka marrë gradën Master i Shkencave në Filozofi, po nga ky universitet. Gjatë periudhës 2001-2002 ka ndjekur një Master në Administrim Menaxhim në Universitetin “Montesquieu BORDEAUX IV” në Francë, ndërsa në vitin 2017 ka marrë gradën “Doktor i Shkencave” në Filozofi .

Gjatë periudhës 2000 – 2007 ka punuar përkatësisht në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe në Institutin e Monumenteve të. Që prej vitit 2008 është e angazhuar si pedagog në Universitetin Marin Barleti, në Departamentin e Shkencave Politike dhe analist, gazetar dhe drejtues i emisionit “BARDHAZI” në TV. SCAN.

Dr. Erion Kristo ka një sërë publikimesh në shtypin e përditshëm i tregimeve, poezive, eseve dhe përkthimeve nga autorë të ndryshëm. Ka shkruar një mori artikujsh kritikë për letërsinë në revista dhe gazeta, redaktor i dhjetëra librave të botuar, bashkëpunëtor në serinë e botimeve të Oxfordit, botuar nga IDEART dhe është fitues i bursës Fullbright Scholar në UCLA Los Angeles, në Departamentin e Shkencave Politike gjatë periudhës janar – korrik 2012. Ka një pjesëmarrje të gjatë si aktivist në shoqërinë civile dhe media dhe një përvojë të gjatë në mësimdhënie në lëndët: “Sociologji”, “Antropologji Sociale”, “Probleme sociale”, etj.